

VENDIM
Nr.193, datë 10.4.2004

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË
DEGËVE TË MOBILIZIMIT NË QYTETET LUSHNJË DHE BALLSH, TË CILAT JANË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR DISA
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediseve të degëve të mobilizimit në Lushnjë dhe Ballsh t’u ndryshojë përgjegjësia e administrimit nga Ministria e Mbrojtjes te prefekti i qarkut të Fierit, për t’u përdorur për sistemin e sektorëve të PMNZSH-së, të Lushnjës dhe Mallakastrës.

2. Pronat me numrat rendorë 862, “Dega e mobilizimit” në Lushnjë dhe 949, “Dega e mobilizimit” në Ballsh, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Prefektit të qarkut të Fierit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në këtë vendim, t’i tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, prefekti i qarkut të Fierit dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano